

## BANKA QENDRORE EVROPIANE

**VENDIMI I BANKËS QENDRORE EVROPIANE, DATË 20 MARS 2003, "PËR PRERJET, SPECIFIKIMET, RIPRODHIMIN, KËMBIMIN DHE TËRHEQJEN E KARTËMONEDHAVE EURO"**

(BQE/2003/4)

(2003/205/KE)

## KËSHILLI DREJTUES I BANKËS QENDRORE EVROPIANE,

Duke pasur parasysh traktatin themelues të Komunitetit Evropian dhe në veçanti nenin 106, paragrafi 1 të tij dhe nenin 16 të statutit të sistemit evropian të bankave qendrore dhe të Bankës Qendrore Evropiane,

Meqë:

1. Neni 106, paragrafi 1, i traktatit dhe neni 16 i statutit parashikojnë që Banka Qendrore Evropiane (BQE) ka të drejtën ekskluzive për të autorizuar emetimin e kartëmonedhave brenda Komunitetit. Po ashtu, këto nene parashikojnë edhe mundësinë që këto kartëmonedha të emetohen nga BQE dhe bankat qendrore kombëtare. Sipas nenit 10 të Rregullores së Këshillit (KE) nr. 974/98, datë 3 maj 1998, "Për futjen e euros"<sup>1</sup>, BQE dhe bankat qendrore kombëtare të shteteve anëtare pjesëmarrëse (në vijim referuar si "BQK") hedhin në qarkullim kartëmonedhat euro.

2. Instituti Monetar Evropian (IME) kreu punën përgatitore për prodhimin dhe emetimin e kartëmonedhave euro, dhe në veçanti në lidhje me dizajnin e tyre, ka lehtësuar njohjen dhe pranimin nga përdoruesit të prerjeve dhe specifikimeve të kartëmonedhave të reja euro, duke marrë në konsideratë kërkesat specifike vizuale dhe teknike të shoqatave evropiane të përdoruesve të kartëmonedhave.

3. Si pasuese e IME, BQE zotëron të drejtat e autorit për dizajnet e kartëmonedhave euro, të cilat tradicionalisht janë zotëruar nga IME. BQE dhe BQK-të që veprojnë në emër të BQE-së, mund ta zbatojnë këtë të drejtë në lidhje me riprodhimet e emetuara ose të shpërndara në shkelje të kësaj të drejte autori si, ndër të tjera, riprodhimet që mund të ndikojnë negativisht pozitën e kartëmonedhave euro.

4. E drejta e BQE-së dhe BQK-ve për të emetuar kartëmonedha euro përfshin kompetencën për të marrë të gjitha masat e nevojshme ligjore për mbrojtjen e integritetit të kartëmonedhave euro si mjete pagese. BQE duhet të marrë masat për të siguruar një nivel minimal mbrojtjeje në të gjitha shtetet anëtare pjesëmarrëse, për të garantuar që publiku i gjerë të mund të bëjë dallimin midis kartëmonedhave euro origjinale dhe riprodhimeve të tyre. Ndaj, është e nevojshme të përcaktohen rregulla të përbashkëta sipas të cilave do të lejohet riprodhimi i kartëmonedhave euro.

5. Dispozitat e vendimit aktual nuk duhet të cenojnë zbatimin e të drejtës penale, sidomos në lidhje me falsifikimin.

6. Riprodhimet e kartëmonedhave euro në formë elektronike duhet të konsiderohen të ligjshme vetëm nëse prodhuesi i tyre merr masat e duhura teknike për parandalimin e printimit të tyre, rast të cilin publiku i gjerë mund t'i ngatërrojë kopjet e printuara me kartëmonedhat origjinale.

7. Kompetenca për marrjen e masave për mbrojtjen e integritetit të kartëmonedhave euro si mjet pagese përfshin kompetencën për të miratuar një regjim të përbashkët sipas të cilit BQK-të janë të gatshme të këmbajnë kartëmonedha euro të dëmtuara. Sipas këtij regjimi, janë përcaktuar disa kategori kartëmonedhash euro që duhen mbajtur nga BQK-të kur u paraqiten për këmbim.

8. Pjesa e kartëmonedhës euro origjinale që duhet të paraqitet për t'u kualifikuar për këmbim u nënshtrohet kërkesave minimale të madhësisë. Këto matje duhet të shprehen si përqindje e sipërfaqes së kartëmonedhës euro origjinale përpara se ajo të dëmtohet, me qëllimin për të parandaluar shtrembërimet e tyre, si për shembull në situatat kur kartëmonedha euro është e dëmtuar nga zhubrosja.

9. Për të nxitur përdorimin e duhur të pajisjeve antivjedhje nga të gjithë trajtuesit profesionistë të kartëmonedhave, kur ata u kërkojnë BKQ-ve që të këmbajnë kartëmonedha euro të dëmtuara nga përdorimi i pajisjeve antivjedhje, është me vend që BKQ-të të vendosin një tarifë për trajtuesit e kartëmonedhave, si kompensim për kryerjen e analizës në lidhje me këmbimin e këtyre kartëmonedhave euro.

10. Kjo tarifë nuk vendoset kur dëmtimi rezulton nga një vjedhje apo tentativë për vjedhje dhe, për të shmangur tarifat e papërfillshme, ajo vendoset vetëm kur paraqiten për këmbim një numër minimal kartëmonedhash euro të dëmtuara.

11. Kartëmonedhat euro që kanë pësuar dëmtim të konsiderueshëm nga përdorimi i pajisjeve antivjedhje, duhet të paraqiten për këmbim në grupe që përmbajnë një numër minimal kartëmonedhash euro.

12. E drejta ekskluzive e BQE-së për të autorizuar emetimin e kartëmonedhave euro brenda Komunitetit përfshin kompetencën për të tërhequr kartëmonedhat euro dhe për të përcaktuar një regjim të përbashkët sipas të cilit BQE-ja dhe BQK-të mund të kryejnë tërheqjen e tyre.

13. Për arsye qartësie dhe sigurie ligjore, është me vend që të kodohet Vendimi BQE/2001/7, datë 30 gusht 2001, "Për prerjet, specifikimet, riprodhimin, këmbimin dhe tërheqjen e kartëmonedhave euro"<sup>2</sup>, i ndryshuar me Vendimin BQE/2001/14<sup>3</sup> dhe bërja më transparente e detyrave të BQE-së dhe BQK-ve në lidhje me rregullat për riprodhimin, këmbimin dhe tërheqjen e kartëmonedhave euro,

MIRATON KËTË VENDIM:

Neni 1

## Prerjet dhe specifikimet

1. Seritë e para të kartëmonedhave euro përfshijnë shtatë prerje nga pesë deri në 500 euro që pasqyrojnë tematikën "Epokat dhe stilet e Evropës", me specifikimet themelore të mëposhtme.

Vlera nominale (EUR)	Përmasat	Ngjyra dominuese	Dizajni
5	120 × 62 mm	Gri	Klasik
10	127 × 67 mm	I kuq	Stili roman
20	133 × 72 mm	Blu	Gotik
50	140 × 77 mm	Portokalli	Rilindja
100	147 × 82 mm	I gjelbër	Barok dhe rokoko
200	153 × 82 mm	E verdhë në kafe	Arkitektura e hekurit dhe xhamit
500	160 × 82 mm	Purpurt	Arkitektura moderne e shek. të 20-të

2. Shtatë prerjet e serive të kartëmonedhës euro përmbajnë figurën e portave dhe dritareve në anën e përparme (djathtas) dhe të urave në anën e pasme (majtas). Që të shtata prerjet janë tipike të periudhave të ndryshme artistike evropiane të përmendura më lart. Elemente të tjera të dizajnit përfshijnë: simbolin e Bashkimit Evropian; emrin e monedhës në alfabetet romake dhe greke; inicialet e BQE-së në variantet e gjuhës së tyre zyrtare; simbolin © që tregon se e drejta e autorit i takon BQE-së; si dhe nënshkrimin e presidentit të BQE-së.

## Neni 2

### Rregullat për riprodhimin e kartëmonedhave euro

1. "Riprodhim" është çdo imazh i trupëzuar ose i patrupëzuar që përdor të gjithë ose një pjesë të një kartëmonedhe euro të specifikuar në nenin 1, apo pjesë të elementeve të veçanta të dizajnit të saj, duke përfshirë ndër të tjera, ngjyrën, përmasat dhe përdorimin e germave apo simboleve, i cili mund të ngjasojë ose të japë përshtypjen e përgjithshme të një kartëmonedhe euro, pavarësisht:

- a) madhësisë së imazhit;
- b) materialit/eve apo teknikës/ave të përdorura për prodhimin e tij;
- c) faktit nëse elementet apo ilustrimet e shtuara në imazh nuk e kanë origjinën nga kartëmonedhat; apo
- d) faktit nëse është ndryshuar apo jo dizajni i kartëmonedhës euro, si germat apo simbolet.

2. Riprodhimet të cilat publiku i gjerë mund t'i ngatërrojë me kartëmonedhat euro origjinale, do të konsiderohen të paligjshme.

3. Riprodhimet që janë në përputhje me kriteret e mëposhtme, do të konsiderohen të ligjshme, duke qenë se nuk ekziston ndonjë rrezik që publiku i gjerë t'i ngatërrojë me kartëmonedhat euro origjinale:

a) riprodhimet e një ane të një kartëmonedhe euro të specifikuar në nenin 1, me kusht që madhësia e riprodhimit të jetë të paktën 125% ose maksimumi 75% i gjatësisë dhe gjerësisë së kartëmonedhës euro përkatëse, siç specifikohet në nenin 1; ose

b) riprodhimet e të dyja anëve të një kartëmonedhe euro të specifikuar në nenin 1, me kusht që madhësia e riprodhimit të jetë të paktën 200 % ose maksimumi 50 % i gjatësisë dhe gjerësisë së kartëmonedhës euro përkatëse, siç specifikohet në nenin 1; ose

c) riprodhimet e elementeve individuale të dizajnit të një kartëmonedhe euro të specifikuar në nenin 1, me kusht që ky element i dizajnit të mos paraqitet në një sfond që ngjan me një kartëmonedhë; ose

d) riprodhimet e një ane në të cilat paraqitet një pjesë e anës së përparme apo e anës së pasme të një kartëmonedhe euro, me kusht që kjo pjesë të jetë më e vogël se një e treta e anës së përparme apo të pasme të kartëmonedhës euro origjinale të specifikuar në nenin 1; ose

e) riprodhimet e bëra prej një materiali që është qartësisht i ndryshëm nga letra dhe i cili ka pamje shumë të ndryshme nga materiali i përdorur për kartëmonedhat; ose

f) riprodhimet jofizike që vihen në dispozicion elektronikisht në faqe interneti, me lidhje kabllore, me valë apo forma të tjera, që i mundësojnë publikut aksesimin e këtyre riprodhime jofizike në vendin dhe kohën e zgjedhur prej tyre, me kusht që:

– të stampohet fjala SPECIMEN diagonalisht në të gjithë riprodhimin, me shkrim Arial ose me një shkrim të ngjashëm me të. Gjatësia e fjalës SPECIMEN është të paktën sa 75% e gjatësisë së riprodhimit dhe gjerësia e saj është të paktën sa 15% e gjerësisë së riprodhimit dhe me ngjyrë jotransparente (opake), e cila ndryshon nga ngjyra dominuese e kartëmonedhës euro përkatëse të specifikuar në nenin 1, dhe

– rezolucioni i riprodhimit elektronik në madhësinë origjinale nuk i kalon 72 dpi (pikëza për inç).

4. BQE dhe BQK-të, pas marrjes së një kërkesë me shkrim, japin konfirmimin se janë të ligjshme edhe ato riprodhime që edhe pse nuk përputhen me kriteret e paragrafit 3 nuk mund të ngatërrohen nga publiku i gjerë me një kartëmonedhë euro origjinale të specifikuar në nenin 1. Kur një riprodhim prodhohet në territorin e vetëm një shteti anëtar pjesëmarrës, kërkesat e përmendura më lart i drejtohen BQK-së së atij shteti anëtar. Në të gjitha rastet e tjera, këto kërkesa i drejtohen BQE-së.

5. Rregullat e riprodhimit për kartëmonedhat euro zbatohen edhe për kartëmonedhat

euro që janë tërhequr apo kanë humbur statusin e monedhës me kurs ligjor sipas këtij vendimi.

### Neni 3

#### **Këmbimi i kartëmonedhave euro të dëmtuara**

1. BQK-të këmbejnë kartëmonedhat origjinale euro me kurs ligjor që janë të dëmtuara, pas kërkesës dhe sipas kushteve të përcaktuara në paragrafin 2, në rastet e mëposhtme:

a) kur paraqitet më shumë se 50% e kartëmonedhave euro; ose

b) kur paraqitet 50% apo më pak e kartëmonedhës euro, nëse aplikanti vërteton se pjesët që mungojnë janë shkatërruar.

2. Përveç paragrafit 1, për këmbimin e kartëmonedhave euro me kurs ligjor që janë të dëmtuara, zbatohen kushtet e mëposhtme shtesë:

a) kur ka dyshime për të drejtën ligjore të aplikantit mbi kartëmonedhat apo autenticitetin e tyre: aplikanti paraqet dokument identifikimi;

b) kur paraqiten kartëmonedha me njolla boje, të ndotura apo të dëmtuara: aplikanti paraqet një shpjegim me shkrim për llojin e njollës, ndotjes apo lyerjes;

c) kur kartëmonedhat euro janë çngjyrosur nga pajisjet e aktivizuara antivjedhje dhe paraqiten nga trajtues profesionistë të kartëmonedhave të përmendur në nenin 6, paragrafi 1, të Rregullores së Këshillit (KE) nr. 1338/2001, datë 28 qershor 2001, "Për përcaktimin e masave të nevojshme për mbrojtjen e euros nga falsifikimi"<sup>4</sup>: trajtuesit profesionistë të kartëmonedhave paraqesin një deklaratë me shkrim mbi shkakun dhe natyrën e neutralizimit;

d) kur kartëmonedhat euro janë dëmtuar në një masë të konsiderueshme nga përdorimi i pajisjeve antivjedhje: ato paraqiten në grupe prej 100 kartëmonedhash euro, me kusht që shumica e kartëmonedhave të paraqitura të jetë e mjaftueshme për të formuar grupe të tilla.

3. Pavarësisht nga sa më sipër:

a) Kur BQK-të janë në dijeni ose kanë arsye të mjaftueshme për të besuar se kartëmonedhat euro janë dëmtuar me qëllim, ato refuzojnë t'i këmbejnë dhe i anulojnë këto kartëmonedha, për të shmangur rikthimin e tyre në qarkullim ose për të parandaluar që aplikanti t'i paraqesë ato për këmbim në një BQK tjetër. Megjithatë, ato do t'i këmbejnë kartëmonedhat e dëmtuara në rast se janë në dijeni ose kanë arsye të mjaftueshme për të besuar se aplikantët veprojnë në mirëbesim apo nëse aplikantët mund të vërtetojnë se veprojnë në mirëbesim. Kartëmonedhat euro që kanë pësuar dëmtime të vogla, si p.sh. ato që përmbajnë shënime, numra apo fjali të shkurtra, si parim, nuk do të konsiderohen si kartëmonedha të dëmtuara qëllimisht; dhe

b) Kur BQK-të janë në dijeni ose kanë arsye të konsiderueshme për të besuar se është kryer një vepër penale, ato refuzojnë t'i këmbajnë kartëmonedhat e dëmtuara dhe i mbajnë ato, kundrejt konfirmimit të marrjes, si provë për t'ua paraqitur autoriteteve kompetente, me qëllim nisjen e një hetimi penal apo në mbështetje të një hetimi penal në proces. Nëse nuk vendoset ndryshe nga autoritetet kompetente, kartëmonedhat euro i rikthehen aplikantit në fund të hetimit penal dhe më pas kualifikohen për këmbim.

#### Neni 4

### **Vendosja e një tarife për këmbimin e kartëmonedhave euro të dëmtuara**

1. Në rastin kur trajtuesit profesionistë u kërkojnë BQK-ve, në përputhje me nenin 3, që të këmbajnë kartëmonedha euro me kurs ligjor të dëmtuara nga përdorimi i pajisjeve antivjedhje, BQK-të vendosin një tarifë për trajtuesit në fjalë.

2. Tarifa do të jetë deri në 10 cent për çdo kartëmonedhë të dëmtuar.

3. Tarifa do të vendoset vetëm nëse këmbehen të paktën 100 kartëmonedha euro të dëmtuara. Tarifa do të vendoset për të gjitha kartëmonedhat euro të këmbyerë.

4. Në rastet kur dëmtimi i kartëmonedhave është shkaktuar nga një tentativë për vjedhje apo nga kryerja e një vjedhjeje, nuk do të vendoset asnjë tarifë.

#### Neni 5

### **Tërheqja e kartëmonedhave euro**

Tërheqja e një lloji apo serie kartëmonedhash euro rregulloret me vendim të Këshillit Drejtues të botuar për informim të përgjithshëm në *Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian* dhe në medie të tjera. Ky vendim mbulon të paktën pikat e mëposhtme:

- llojin ose serinë e kartëmonedhës euro që do të tërhiqet nga qarkullimi, dhe
- kohëzgjatjen e periudhës së këmbimit, dhe
- datën në të cilën lloji ose seria e kartëmonedhës euro do të humbasë kursin ligjor dhe
- trajtimin e kartëmonedhave euro që paraqiten pas përfundimit të periudhës së tërheqjes dhe/ose pasi kanë humbur kursin e tyre ligjor.

#### Neni 6

### **Dispozita përfundimtare**

1. Vendimet BQE/2001/7 dhe BQE/2001/14 shfuqizohen.
2. Referimet në Vendimet BQE/1998/6<sup>5</sup>, BQE/1999/2<sup>6</sup>, BQE/2001/7 dhe BQE/2001/14 interpretohen si referime në këtë vendim.

3. Ky vendim hyn në fuqi një ditë pas botimit të tij në *Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian*.

Nënshkruar në Frankfurt am Main, më 20 mars 2003.

Në emër të Këshillit Drejtues të BQE-së

Willem F. DUISENBERG

---

1. *Gazeta Zyrtare L 139, 11.5.1998, f. 1.*

2. *Gazeta Zyrtare L 233, 31.8.2001, f. 55.*

3. *Gazeta Zyrtare L 5, 9.1.2002, f. 26.*

4. *Gazeta Zyrtare L 181, 4.7.2001, f. 6.*

5. Vendimi BQE/1998/6, datë 7 korrik 1998, "Për prerjet, specifikimet, riprodhimin, këmbimin dhe tërheqjen e kartëmonedhave euro, *Gazeta Zyrtare L 8, 14.1.1999, f. 36.*

6. Vendimi BQE/1999/2, datë 26 gusht 1999 "Për ndryshimin e Vendimit BQE/1998/6, datë 7 korrik 1998, "Për prerjet, specifikimet, riprodhimin, këmbimin dhe tërheqjen e kartëmonedhave euro", *Gazeta Zyrtare L 258, 5.10.1999, f. 29.*

---